



	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË	UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEQA" PEJË	
REKTORATI			
Nr. / Br. / No. <u>291</u>		Nr. i faq/ Br. str / No. pg <u>3</u>	
Data / Datum / Date: <u>15.02.2019</u> Pejë / Peë			

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEQA"

Adresa, Rruga e UÇK-së, 30000, Pejë - Republika e Kosovës, Nr. Tel +381 039 432 270, info@unhz.eu

RREGULLORE PËR PUNËN E QENDRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRIERËS NË UNIVERSITETIT "HAXHI ZEQA" NË PEJË

PEJË 2019

Këshilli Drejtues i Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, në bazë të nenit 17 dhe 22, të Statutit të Universitetit në mbledhjen e mbajtur me 15. 02. 2019 miratoi:

RREGULLORE PËR PUNËN E QENDRËS PËR ZHVILLIMIN E KARRJERËS NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregullore është përcaktimi dhe mënyra e punës së qendrës së karrierës në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë.

Neni 2

Fushëveprimi

Kjo rregullore rregullon punën e qendrës për zhvillimin e karrierës në zhvillimin personal dhe profesional të studentëve përmes informimit, këshillimit, trajnimit, ndërmjetësimit më punëdhënësin, hartimit të dokumenteve profesionale në fushën e karrierës dhe udhëzimit në karrierë.

Neni 3

Detyrat e qendrës për zhvillimin e karrierës

1. Inicon marrëveshje të mundshme mes UHZ-së dhe organizatave – kompanive të ndryshme, me qëllim të krijimit të vendeve për punë praktike apo edhe punësimit të studentëve të UHZ-së;
2. Mbanë takime me stafin menaxherial, stafin akademik, stafin administrativ të Universitetit, me punëdhënësin, vizitorë të huaj.
3. Koordinon hulumtime të ndryshme që realizon QZHK-së dhe TK-së si dhe harton plane për zbatimin e të gjitha aktiviteteve të QZHK-së;
4. Merr pjesë në konferenca, seminare, trajnime, tryeza të rrumbullakëta që ndërliken me zhvillimin e karrierës të studenteve.

Neni 4

Përgjegjësitë e qendrës për zhvillimin e karrierës

1. Puna në zhvillimin e aftësive, njohurive dhe shkathtësive të cilat janë kyçe për procesin e punësimit të studentëve dhe të diplomuarve;
2. Ofrimi i ndihmës studentëve dhe të diplomuarve të UHZ-së që të vinë deri tek informacioni për mundësitë e arsimimit shtesë, mundësitë e punës praktike dhe aktiviteteve të ndryshme;
3. Organizimi i trajnimeve për studentët, konferencave, bisedave dhe prezantimeve të punëdhënësve me qëllim që studentët ta kuptojnë më mirë tregun e punës dhe t'i zotërojnë shkathtësitë që janë të nevojshme për organizimin dhe planifikimin e suksesshëm të karrierës

personale;

4. Bashkëpunimi me fakultetet e Universitetit "Haxhi Zeka " në Pejë, në shpërndarjen e informacioneve për studentët dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta;
5. Ofrimi i shërbimeve për kompanitë si prezantimin e ofertave të tyre për punë dhe punë praktike para studentëve dhe të diplomuarve dhe biseda me këta ofertues.

Neni 5

Krijimi i Marrëdhënieve me të diplomuarit (ish studentët)

1. Qendra për zhvillimin e karrierës duhet të bëjë krijimin dhe zhvillimin e kontakteve të vazhdueshme me të diplomuarit me qëllim të mbledhjes së informacionit nga ish-studentët pas diplomimit dhe punëdhënësve për të vlerësuar rëndësinë e njohurive dhe aftësive të fituara gjatë studimeve. Duke bërë këtë, UHZ synon të kuptoj trendet në punësim dhe aftësitë e kërkuara të të diplomuarve që të mund të informojnë zhvillimin e vazhdueshëm të programit.
2. Qendra për zhvillimin e karrierës në koordinim më Sekretarin e Përgjithshëm organizon ceremoninë e diplomimit çdo vit për studentet e nivelit bachelor dhe master.

Neni 6

Struktura Organizative

Qendra për zhvillimin e karrierës udhëhiqet nga Kryesuesi i Zyrës, i cili raporton tek Sekretari i Përgjithshëm dhe sipas nevojës të Prorektori për Mësimdhënie dhe Çështje Studentore në UHZ.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Kryesues i Këshillit Drejtues

Nur Çeku

